

## SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIKIIN)

### Madhërimi / *et-Ta'dhim* / التعظيم

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ tha:

" ﷻ "

“Çfarë keni që nuk i atribuoni Allahut madhështinë që Ai ka.” (Nuh, 13)

Madhërimi nënkupton ta pranosh madhështinë e Tij ndërsa tregon përulësi para saj. Kjo ka tri nivele:

Niveli i parë është madhërimi i urdhrave dhe ndalimeve. Kjo nënkupton që:

- të mos bëhet kompromis me to duke bërë lëshime të paarsyeshme
- të mos trajtohen me rreptësi të tepruar
- të mos lidhen me shkaqe që mundin ta dobësojnë dëgjueshmërinë<sup>1</sup>

Niveli i dytë është madhërimi i caktimeve. Kjo nënkupton që:

- të mos mendohen si të padrejta<sup>2</sup>
- të mos kundërshtohen me dije<sup>3</sup>

<sup>1</sup> Një urdhër mund të ketë më shumë se një shkak. Atribuimi i ngutshëm i shkaqeve urdhrave dhe ndalimeve mund të përfundojë në mospranimin e tyre aty ku duhet të zbatohen. Përveç kësaj, urtësia (*hikmeh*) e pamatshme (e fundme) nuk mund të përdoret për t'iu shmangur ligjeve. Për shembull, personi s'mund të thotë se qëllimi i namazit është për ta forcuar lidhjen me Allahun dhe që të të ndalojë nga e keqja, kështu që, ata që përjetojnë një marrëdhënie të ëmbël me Allahun dhe përmbahen nga e keqja, nuk kanë nevojë të falin namaz.

<sup>2</sup> Të gjithat caktimet e Allahut janë të drejta dhe të mira, edhe nëse ajo që caktohet nuk është, siç thekson Ibn el-Kajjim në *el-Medaarixh*. Kur Ai cakton që dikush të bëjë një padrejtësi, personi është fajtor për atë caktim përbrenda planit të Tij të përfshirës. E keqja nuk i atribuohet Allahut, siç tha pejgamberi ﷺ, edhe pse të gjitha caktimet, të mirat e të këqijat, janë të Tij, siç konfirmoi edhe ai ﷺ.

- të mos kërkohet dëmshpërblim<sup>4</sup>

Niveli i tretë është madhërimi i të Vërtetit – lavdi i qoftë Atij – që nënkupton:

- të mos njohësh ndonjë shkak tjetër veç Tij<sup>5</sup>
- të mos shohësh se ke ndonjë të drejtë karshi Tij
- të mos u rezistosh zgjedhjeve që bën Ai<sup>6</sup>

---

<sup>3</sup> Mënyra e duhur për ta kuptuar këtë, siç sqaron Ibn el-Kajjim në *el-Medaarixh*, është që të supozojmë se shejhu (el-Harawi) mendoi se caktimet e Allahut që ndodhin dhe dija e Shpalljes që Ai na dha janë prej Tij dhe nuk bien ndesh me njëra-tjetrën.

<sup>4</sup> Nuk bën të mendojmë se kemi ndonjë meritë karshi Allahut. Durimi i hirshëm gjatë caktimeve të vështira është obligim yni. Kjo, megjithatë, nuk nënkupton që Ai i cili është bujari më i madh nuk na shpërblen për këtë durim. Kjo, po ashtu, nuk do të thotë që ne të mos gjejmë prehje në premtimet e Tij.

<sup>5</sup> Allahu është shkaku i parë dhe i fundit, prandaj të gjitha shkaqet duhet t'i trajtojmë si mjete të vendosura nga Ai për arritjen e qëllimeve. Ato nuk ndikojnë vetvetiu; ato ndikojnë vetëm me lejin e Tij në kuadër të Rendit Universal të cilin e krijoi vetë Ai dhe vetë e mirëmban.

<sup>6</sup> Urdhrat e Tij janë të njohur për ne dhe ne duhet t'u nënshtrohemi atyre. Caktimet që na kanë goditur, duhet pranuar. Caktimet që ende s'kanë ndodhur, janë të panjohura për ne. Pavarësisht se sa të pashmangshme duken caktimet, ne kërkojmë të mirën dhe mundohemi t'i ikim dhe t'i rezistojmë të dëmshmes. Krejt kjo është e përmbledhur në thënien e pejgamberit ﷺ:

“Besimtari i fortë është më i mirë dhe më i dashur për Allahun sesa i dobëti dhe të dy janë të mirë. Kërko me zell të dobishmen, vazhdo ta lusësh Allahun dhe mos u ligështo. Nëse të godet ndonjë gjë, mos thuaj ‘Sikur t’ia bëja kështu, do të bëhej kështu.’ Thuaj vetëm ‘Allahu caktoi çështjen dhe bëri si deshi.’ Fjala ‘nëse’ i hap dyert cytjeve të dreqit.” (Muslim)